



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

**Nr.55 dt.27.03.1997**

**PER  
MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE TE SHERBIMIT ME  
KARAKTER TE PERKOHSEM PER VITIN 1997.**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.27.03.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës “Për miratimin e disa taksave dhe tarifave të përkohëshme për vitin 1997”, mbështetur në ligjin Nr.7777, dt.22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, neni.4 i tij

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë vjeljen e të gjitha taksave lokale për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në objektet e ngritura pa leje deri në veprimin ndaj tyre sipas ligjit. Vjelja e taksave të bëhet nga strukturat e ngritura tatimore pranë Bashkisë.
2. Të miratojë Taksë vendi për vendqëndrimet e përkohëshme të automjeteve të çdo lloji sipas tarifave të përcaktuara në vendimin Nr.84, dt.30.04.1996 të Këshillit të Bashkisë Tiranë.
3. Të miratojë tarifën vjetore për pisjen me leje për orët jashtë orarit normal të punës për subjektet tregëtare dhe lejet e aktivitetit tregëtar ambulator si vijon :
  - për dhënie leje për aktivitet 24orësh (nonstop) tarifa caktohet 5.000 lekë.
  - për dhënie leje për aktivitet jashtë orarit normal të punës tarifa caktohet 2.000 lekë.
  - për dhënie leje aktiviteti tregëtar ambulator tarifa caktohet 3.000 lekë.

Pajisja me leje bëhet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Bashki dhe Sektori i Tregëtisë në përbërje të saj.

4. Të miratojë taksën e tavolinës në masën 30 lekë për tavolinat jashtë sipërfaqes së miratuar të ndërtimit kur pronari i lokalit nuk është pronar i truallit. Për objekte të ngritura pa leje kjo tarifë të shtrihet në të gjithë tavolinat e disponueshme.

5. Të miratojë tarifat e shërbimit ndaj popullit që kryejnë Njësitë administrative si vijon :

- dhënie vërtetimi për liçensë 150 lekë
- dhënie vërtetimi për dokumenta automjeti 150 lekë
- dhënie vërtetim për pasaportë 100 lek
- dhënie vërtetime të tjera të ndryshme 50 lekë
- Autorizime për dhënie pensionesh pleqërie të jepen falas.

6. Të miratojë tarifat e shërbimit të Sektorit të Arshivës së Bashkisë si vijon :

- për nxjerrje dokumentash për efekte pensioni 50 lekë
- për nxjerrje dokumentash të tjera të çdo lloji 500 lekë

7. Të miratojë tarifat për shërbimet ndaj popullatës nga ana e Drejtorisë së Strehimit të Bashkisë si vijon :

- për dhënie autorizimi për apartament 500 lekë
- për dhënie autorizimi për strehim të përkohshëm 500 lekë
- për dhënie leje banimi 500 lekë
- për dhënie vërtetim si i pastrehë 100 lekë

8. Për dhënie leje për shitje vajguri dhe gazi të lëngshëm për të gjithë subjektet fizike dhe juridike caktohet tarifa 1.500 lekë/vit me dhënien e lejes nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike(Sektorit përkatës).

9. Likujdimi i tarifave përkatëse bëhet në momentin e kryerjes së shërbimit dhe pajisjes me dokumentin përkatës sipas rregullave të përcaktuara ligjore dhe urdhëresave të dala për këtë qëllim.

10. Vjelja e taksës së vendqëndrimit të mjeteve të transportit të bëhet sipas vendimit Nr.84, dt.30.04.1996 të Këshillit të Bashkisë Tiranë.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Ndërmarrja e Tregut të Lirë, Drejtoria e Përgjithshme e Personelit dhe Organizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme

e Urbanistikës dhe Drejtoria e Financës nëpërmjet sektorëve përkatës që kanë në varësi.

12. Efekti i këtij vendimi shtrihet deri në fund të vitit 1998 me të drejtën e propozimeve për ndryshime në rast se shihet e nevojshme nga sektorët përkatës.

13. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**ORHAN SAKIQI**